

L I G J
Nr. 8899, datë 22.5.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG
SHA-SË**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton formën dhe formulën e privatizimit të Institutit të Sigurimeve INSIG sha-së.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Aksion” nënkupton një aksion në kapitalin e INSIG sha-së.
2. “Institucione financiare ndërkombëtare” nënkupton institucionet e krijuara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, që veprojnë në sektorët e investimeve financiare, dhe shoqëritë risiguruese ndërkombëtare, të njohura në tregun ndërkombëtar të sigurimeve.
3. “Investitor strategjik” nënkupton një shoqëri të huaj sigurimesh e njohur në tregun ndërkombëtar të sigurimeve, e cila nuk është rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk është themeluar sipas ligjit shqiptar, e cila ka sukses në një ose më shumë tregje të huaja sigurimesh gjatë 20 viteve të fundit dhe ka të paktën 250 milionë USD asete neto dhe 1,5 miliard USD të totalit të aseteve.
4. “Subjekt i sektorit privat shqiptar” nënkupton një shoqëri shqiptare, rezidente në territorin e Republikës së Shqipërisë ose e themeluar sipas ligjit shqiptar.

Neni 3

Forma e privatizimit

1. Forma e privatizimit të INSIG sha-së është ajo e transferimit me anë të shitjes të së drejtës së pronësisë mbi aksionet ekzistuese të shoqërisë, nëpërmjet negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare dhe përzgjedhjes së investitorëve strategjikë, nëpërmjet procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar, sipas formulës së parashikuar në nenin 4 të këtij ligji.
2. Vlera e aksioneve, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre institucioneve ndërkombëtare financiare, bëhet nga një vlerësues ndërkombëtar i njohur në këtë fushë, i cili do të zgjidhet, sipas procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar. Kjo vlerë miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili miraton edhe marrëveshjen për transferimin e të drejtës së pronësisë së aksioneve të shoqërisë anonime INSIG sha, me anë të negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare.

Neni 4

Formula e privatizimit

Struktura e formulës së privatizimit të INSIG sha-së është si më poshtë:

1. Jo më shumë se 40 për qind e aksioneve transferohen nëpërmjet shitjes, me anë të negociatave me institucionet financiare ndërkombëtare, jo më vonë se 12 muaj nga data e hyrjes në

fuqi të këtij ligji.

2. Jo më pak se 60 për qind e aksioneve u shiten investitorëve strategjikë dhe subjekteve të sektorit privat shqiptar. Nga kjo paketë aksionesh ofrohen për shitje jo më pak se 51 për qind për investitorin strategjik dhe pjesa e mbetur u ofrohet për shitje subjekteve të sektorit privat shqiptar me ofertë publike. Përzgjedhja e investitorit strategjik për blerjen e aksioneve bëhet brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes për transferimin e aksioneve institucioneve financiare ndërkombëtare dhe, në asnjë rast, nuk mund të zgjasë më shumë se 24 muaj. Procedurat për shitjen e aksioneve për investitorët strategjikë, sipas parashikimeve të kësaj pike, bëhen nga Ministria e Financave dhe institucionet financiare ndërkombëtare, me cilësinë e aksionerëve në këtë shoqëri, procedura të cilat do të jenë ato të tenderit të hapur ndërkombëtar.

Neni 5

Monedha e pagesës

Transferimi i aksioneve investitorëve të përzgjedhur, sipas këtij ligji, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe investitorët strategjikë, bëhet në një monedhë të huaj, të përcaktuar nga shitësi i aksioneve. Në rastin e shitjes së aksioneve subjekteve të sektorit privat shqiptar, pagesa e tyre kryhet në një monedhë të huaj të përcaktuar, ose në lekë, e konvertuar me kursin ditor të bankës ku kryhet pagesa.

Neni 6

Aksionet e mbetura

Në rast se pas përzgjedhjes së investitorëve strategjikë dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, sipas nenit 4 të këtij ligji, mbeten aksione të pashitura, ato u shiten nga Ministria e Financave, brenda 5 vjetëve, nëpërmjet ofertës publike, subjekteve të sektorit privat shqiptar.

Neni 7

Detyrime të investitorëve

1. Investitorët pjesëmarrës në procesin e privatizimit të INSIG sha-së janë të detyruar të plotësojnë të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe, në mënyrë të veçantë, kërkesat e parashikuara nga legjislacioni tregtar dhe ai i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

2. Investitorët e përzgjedhur sipas këtij ligji duhet të bien dakord, si një kusht paraprak për zotërimin e aksioneve të shoqërisë INSIG sha, për të miratuar çdo ndryshim të nevojshëm të statutit të INSIG sha-së, për nënshkrimin e aksioneve të shoqërisë nga aksionerët e rinj, siç parashikohet në këtë ligj, dhe të mbrojnë të drejtat e aksionerëve në minorancë të shoqërisë, sipas standardeve moderne të drejtimit të përbashkët.

Neni 8

Zbatimi i privatizimit

Ministria e Financave, në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, të cilave u është transferuar paketa e aksioneve, sipas pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të kryejnë procedurat e privatizimit të INSIG sha-së, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të miratuara sipas nenit 9 të këtij ligji.

Neni 9

Nxjerrja e akteve

Këshilli i Ministrave, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji, miraton aktet nënligjore për procedurat e përzgjedhjes së investitorit strategjik.

Neni 10
Zgjidhja e investimeve

Ministria e Financave të paraqesë për miratim përpara procesit të privatizimit të INSIG-sha-së aktet e nevojshme nënligjore për zgjidhjen e problemeve të investimeve të kryera nga INSIG sha-ja, për të rritur vlerën e shitjes së kësaj shoqërie.

Neni 11

Ministria e Financave dhe Komisioni i Mbikëqyrjes i Sigurimeve të nxjerrin, brenda datës 31.10.2002, aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3364, datë 5.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani